



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201700475/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandojmë rishqyrtimin e dosjes së pensionit të pleqërisë dhe rillogaritjen e masës së pensionit të shtetasit A.A.*

Drejtuar: **Z. Arsim RAMA**
Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore

TIRANË

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi A.A, në përmbajtjen e së cilës ankohet për masën e ulët të pensionit të pleqërisë dhe kërkon rillogaritjen e pensionit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sipas shpjegimeve të tij, shtetasi A.A, është përfitues i pensionit të pleqërisë. Ka punuar në sektorin e naftës dhe gazit si dhe të përpunimit, nga punët më të vështira me ndotje ambjenti, me lagështi dhe me shumë elementë të dëmshëm për shëndetin.

Ankuesi pretendon se bazuar në vjetërsinë e punës, rreth 43 vjet dhe funksionet që ai ka patur, masa e pensionit që ai gëzon duhet të jetë më e lartë nga sa i është caktuar.

Për t'iu mundësuar rillogaritja e pensionit të pleqërisë, ka kërkuar ndërmjetësimin tonë institucional.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë*

rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Rishqyrtimin e dosjes së pensionit të pleqërisë dhe rillogaritjen e masës së pensionit të shtetasit A.A.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",*

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI